



MESAZH URIMI
ME RASTIN E FITËR
BAJRAMIT 1440/2019



"KRYET NALT",
SHFAQET DOKUMENTARI PËR
DIJETARIN HAFIZ ALI KRAJA



KËSHILLA TË SHEK. XVII
PREJ NJË KORÇARI TE MENÇUR
E QË VLEJNË EDHE SOT ...

Viti 17 - Nr. 6 (196),
Qershor, 2019

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Fitër Bajrami, festë e madhe për besimtarët!



SIÇILIA KA ISLAM NË ADN-NË E SAJ QYTETI KU XHAMITË ISHIN KISHA, E KISHAT XHAMI

Ajo që duhet kujtuar është se Siçilia ishte dikur një fortesë islame, për më shumë se 200 vite. Ndërmjet shekujve IX dhe XI, ishulli mesdhetar, kryeqyteti i së cilës është Palermo, ende mban pjesë të historisë islame, si fizikisht, ashtu edhe kulturalisht.

Siçilianët ndryshojnë nga pjesa tjetër e Evropës, pasi kanë një prirje natyrore ndaj diversitetit. Siçilianët kanë këtë prirje për botën islame në ADN-në e tyre.



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë Zotit të vetëm të gjithësisë, All-llahut të Madhëruar, i Cili urdhëron në suren “El-Haxh”: “S’ka dyshim se ata të cilët nuk besuan vazhdojnë të pengojnë prej rrugës së All-llahut, edhe prej xhamisë së shenjtë (Qabes), të cilën Ne e bëmë të barabartë për njerëzit, qofshin vendas ose të ardhur, dhe kushdo që të përpiqet të bëjë ndonjë të keqe a ndonjë gjynah, Ne kemi për t’ua shijuar një dënim të dhimbshëm”.¹

Salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë sot, në këtë ditë dhe në çdo ditë të jetës sonë, më të dashurit e më të shtrenjtë, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhammedit (a.s.), i cili porosiste: “Pasojeni haxhin dhe umren, sepse pasimi i tyre e zhduk varfërinë dhe gjynahet, siç farkëtimi ndryshkun e hekurit!”.²

TË DASHUR DHE TË SHTRENJTË BESIMTARË,

Vazhdojmë të falënderojmë All-llahun e Madhëruar për mirësinë e madhe që na dhuroi, duke na bërë të përfjetojmë ato mrekulli të panumërta në atmosferën e begatë të muajit Ramazan, që i la vendin këtij muaji të begatë, Shevvalit përcjellës.

Kaluam ditë dhe net, ku u mbush zemra me kënaqësi e bekim, ku përjetimet ishin të jashtëzakonshme, ku u gëzua i madh dhe i vogël, i varfër dhe i pasur, i largët dhe i afërt, përveç atij që nuk desh të hynte në këtë lulishte të garantuar të bekimeve hyjnore!

Tashmë, dalëngadalë po bëhemi gati të hyjmë në atmosferën e një adhurimi tjetër të mrekullueshëm, të cilin shumë

“PËRKUJTOJE KUR NE E UDHËZUAM IBRAHIMIN PËR NË VENDIN E SHTËPISË (QABES)...”

prej nesh e kemi realizuar, falë mirësisë dhe mbarësisë së All-llahut, sikurse të shumtë janë ata që presin me padurim t’i jepet mundësia për të dëshmuar gatishmërinë e tyre për thirrur me zemër e me tërë zërin e tyre: “Lebbejkall-llahumme lebbejke! Lebbejke la sherike leke lebbejke! Innel-hamde ven-ni’mete leke vel-mulk la sherike leke!”.

Haxhi me krejt madhështinë e tij na shfaqet horizonteve, duke na ftuar të lexojmë me qetësi dhe thellim ajetet e sures që mban emrin e këtij adhurimi, për të kuptuar mësimet dhe udhëzime të mëdha, që na shërbejnë për krejt jetën dhe dëshmimin tonë në të, si rrugëtues besnikë drejt realizmit të asaj dëshmie të madhe e të shtrenjtë, që të veshur me rrobat e bardha të ihramit, nuk e heqim nga goja; “Lebbejke...”!

Ajeti me të cilin sapo nisa hytben e kësaj jave, është edhe fillimi i një cikli mësimesh që na shërben Kur’ani Famëlartë, për të na marrë për dore drejt kuptimeve të Haxhit dhe veshjen madhështore me dashuri, mëshirë, falje e bekim, që i ka dhuruar All-llahu i Madhëruar këtij adhurimi dhe vepruesve të tij.

Fillimisht, na tregohet se femohuesit dhe kundërshtarët e fesë, që si duket do të jenë deri sa të ketë jetë në këtë botë, do të vazhdojnë të pengojnë besimtarët dhe njerëzit drejt rrugës së All-llahut, drejt çdo gjëje që shpie drejt kënaqësisë së Tij, drejt çdo gjëje që e afron njeriun me All-llahun dhe, nuk do ndalemi shumë në këtë detaj, sepse argumentet që e faktojnë këtë realitet, po na bëhen përherë e më të qartë në ditët e sotme!

Por, nëse lexojmë me vëmendje, Zoti i gjithësisë ka lidhur së bashku këto dy fjalë: “rrugës së All-llahut, edhe prej xhamisë së shenjtë (Qabes)”, si për t’i thënë besimtarëve, se: “Sikur Xhamia e Shenjtë (Mesxhidi Harami), të kompenson për çdo gjë tjetër që bën në rrugën e All-llahut. Ashtu sikurse krejt veprat e mira, si kërkimi i dijes, mësimi i saj, shpenzimi i pasurisë, krejt adhurimet, zekati, agjërimi, etj. janë rrugë drejt All-llahut, edhe Xhamia e Shenjtë është rrugë drejt All-llahut!”.³

Pastaj na dëshmon se Qabja e Madhnueshme është e krejt besimtarëve, njësoj si vendlindja që është e shtrenjtë dhe e dashur, e pamohueshme dhe sa herë të largohemi prej saj na merr malli për erën e saj, për ujin, për tokën, për ajrin, për njerëzit; poashtu Qabja e Madhnueshme është e dashur për zemrën, na merr malli për të, mallëngjehemi sa herë përmendet, na e do xhani ajrin e saj, flladet e ngrohta dhe sekretet e dashnisë që ndjehen kur je atje!

Haxhi me krejt madhështinë e tij na shfaqet horizonteve, duke na ftuar të lexojmë me qetësi dhe thellim ajetet e sures që mban emrin e këtij adhurimi, për të kuptuar mësimet dhe udhëzime të mëdha, që na shërbejnë për krejt jetën dhe dëshmimin tonë në të...

Prandaj thotë: “Ne e bëmë të barabartë për njerëzit, qofshin vendas ose të ardhur”, sepse: “Kudo që të shkosh, nuk të shqitet ndjesia se je në këtë apo atë vend por, kur ti hyn në Qaben e Madhnueshme, nuk ndjen më se je në Arabinë Saudite, por ndjen thellë se ke hyrë në Shtëpinë e All-llahut... Kjo Shtëpi është e të gjithëve!”.⁴

Kështu që, asnjë gjynah nuk lejohet në atë vend! Asnjë humbje kohe, asnjë thashethem, asnjë ligësi, asnjë dëmtim ndaj vetes, tjetrit, kafshës, insektit, bimës e çdo gjëje tjetër!

“Ai është vend i pastër vetëm për adhurim, një vend që i kujton njerëzve jetën e përtejme dhe takimin me Zotin e botëve! ... Është Shtëpi e shenjtë, në muaj të shenjtë, All-llahu e ka quajtur të shenjtë; sepse çdo e keqe e lëndim ndalohet në atë vend, deri edhe gjuetia, që diku tjetër është e lejuar... Prandaj, kushdo që hyn në atë vend është i sigurt!...”.⁵

4. Po aty, f. 540.
5. Po aty, f. 540.

TË DASHUR DHE TË SHTRENJTË,

Ajeti vijues na mëson për ca të vërteta historike dhe shpirtërore të jashtëzakonshme. All-llahu i Madhëruar urdhëron: “Përkujtoje kur Ne e udhëzuam Ibrahimin për në vendin e Shtëpisë (Qabes): të mos më përshkruash Mua shok, pastroje shtëpinë Time për ata që e vizitojnë (bëjnë tavaf), që qëndrojnë në këmbë duke u falur, përkulur dhe që bëjnë sexhde”.⁶

All-llahu ekber për këtë mirësi të madhe! Zoti i gjithësisë, për hatrin tim dhe tuajin, për hatrin e krejt besimtarëve të Tij, deri në kiamet, ka dërguar halilin e Tij, Hz. Ibrahimin (a.s.), që të rindërtojë Shtëpinë e Tij, ta pastrojë atë dh eta bëjë gati për rata që e mësyjnë për tavaf, adhurim e namaz, për lutje e adhurim!

Si për të na thënë, sot e mot se, ky vend është vend i pastër; ajka e të dërguarve janë përkujdesur për të, aty është era e tyre, gjurma dhe dashnia e tyre! Aty, kur të hyni me krye për tokë, ndjeni shërbimin e Hz. Ibrahimit, punën e palodhshme të Hz. Ismailit, sakrificën dhe thirrjen e Hz. Muhammedit (a.s.), pastaj ngrijeni kokën me përlujtje e dashni, vështroni në zemër të Qabes së Madhnueshme, mbushuni me frymë dhe thirrni me krejt qenien tuaj: All-llaaah..! Madhërojeni dhe falënderojeni pa masë, lutuni dhe kërkoni prej Tij se, dua juaj në atë moment është lutje që nuk kthehet!

“Zoti ynë, për një urtësi shumë të madhe, e vendosi Qaben e Madhnueshme në një luginë të thatë e të shkretë, pa gjelbërim, që të mos e vizitojë veçse haxhiu! Sepse, sikur të ishte në një luginë të gjelbër, me klimë të butë, me liqene marramendëse e male të gjelbëruara, atë do ta vizitonin haxhilerë e turistë, por jo..! Ai që shkon në atë vend me sinqeritet të madh, thotë: Nuk kam shijuar në jetën time bekim e lumturi më të madhe sesa kënaqësia e e përjetuar në haxh!”.⁷

All-llahu ia lehtësoftë haxhilerëve tanë të këtij viti! Na bëftë prej tyre dhe na udhëzoftë drejt më të mirës në jetë!

(Hytbeja e datës 14 qershor 2019 në xhaminë e Parrucës)

6. Kur’ani, El-Haxh: 26.
7. Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi, Tefsirun-Nabulsi, vëll. i 5-të, f. 541.

MESAZH URIMI ME RASTIN E FITËR BAJRAMIT 1440/2019

Të gjitha falënderimet e plota i takojnë vetëm All-llahut, Zotit të Vetëm të Gjithësisë.

Salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë në këtë ditë dhe në çdo moment të jetës sonë, më të mirit dhe më të shtrenjtë të krijesave të All-llahut, Hz. Muhammedit (a.s.), i cili u dërgua mëshirë për të gjitha krijesat.

Të nderuar vëllezër dhe motra besimtarë,

Me rastin e Fitër Bajramit të sivjetshëm, më lejoni t’ju përhapoj me zemër, Zoti i gjithësisë t’ju ketë pranuar adhurimin tuaj gjatë muajit të begatë të Ramazanit.

Ky muaj, në të cilin të gjithë ne u munduam në një mënyrë a një tjetër, të përkushtohemi maksimalisht për t’i dëshmuar All-llahut të Madhëruar, më të mirën nga vetja e jonë.

Ky muaj, në të cilin u angazhuam për të respektuar faljen e namazit, për të respektuar agjërimin, për të respektuar kufijtë e hallallit dhe të haramit, për të respektuar lidhjet farefnore, për të respektuar forcimin e marrëdhënieve brenda familjes sonë, për të respektuar mexhliset e Kur’anit, për të respektuar tubimet e dijes, për të respektuar ndihmën ndaj të varfërve, jetimëve, skamnorëve, të sëmurëve, të pastrehëve, që sa të shumtë janë sot në realitetet shqiptare.

Prandaj lutem me zemër, që All-llahu i Madhëruar të na begatojë, të na pranojë dhe, këto adhurime të na shërbejnë si një mundësi e mirë për t’i dëshmuar Zotit, vetes dhe njëri-tjetrit, aftësinë edhe mundësinë për të bërë përherë më të mirën në jetën tonë të përkohshme të kësaj bote.

Me rastin e Fitër Bajramit, ju uroj çdo bekim, sikurse lutem që atmosfera e kësaj Dite të Begatë të jetë reflektim i mëshirës, faljes, bamirësisë, shpirtgjerësisë, zemërmadhësisë, që përjetuam gjatë muajit të begatë të Ramazanit.

I lutem All-llahut të Madhëruar, nga ky vend i bekuar, pranë Resulull-llahut (a.s.), që dita e Fitër Bajramit dhe ato që e pasojnë, të jenë një mundësi e mirë për të dëshmuar gjithsecili prej nesh aftësinë e tij për të ndërtuar në jetën e përditshme marrëdhënie të shkëlqyera me njëri-tjetrin, brenda familjes, me farefnisin, me punën, si dhe për të dëshmuar ditë pas dite aftësinë tonë për t’u rritur dhe për t’u lartësuar drejt më të mirës, sipas udhëzimit dhe porosive të Zotit të gjithësisë dhe Pejgamberit tonë, Hz. Muhammedit (a.s.).

All-llahu e begatoftë Shkodrën, Shqipërinë dhe mbarë ymetin islam, me bekimet dhe mëshirën e Tij, për të cilën kemi shumë nevojë!

Paqja dhe begatia mbuloftë vendin dhe shoqërinë tonë, për ta nxjerrë atë nga errësira ku është zhytur, drejt dritës së përparimit, qytetërimit, zhvillimit dhe ecjes hap pas hapi me vendet e qytetëruara, ku besimi dhe vlerat e tij respektohen, nderohen dhe janë busull orientimi për mbarë shoqërinë!

All-llahu ju dashtë dhe ju pranoftë!

Me zemër të mirë Fitër Bajramin!

Myftiu i juaj,

Imam Muhamed Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Medina e Ndriçuar,

më 3 qershor 2019



SIÇILIA KA ISLAM NË ADN-NË E SAJ: QYTETI KU XHAMITË ISHIN KISHA, E KISHAT XHAMI

Qendra Kulturore Islame në Via Roma të Palermos kumbon lehtë nga zëri i disa fëmijëve që praktikojnë leximin e Kur'anit në këtë objekt shpeshherë të zbrazët.

Dy nga dhjetëra lexuesit ikin nga grupi dhe luajnë kukafshehtas ndërmjet perdeve që ndajnë pjesën e fëmijëve nga ajo e të rriturve.

Por me sa hyn imami, Sehab Uddin, aty dëgjohet vetëm miza.

Tashmë shtëpia e mbi 25,000 emigrantëve nga vendet me shumicë muslimane, Palermo është bërë simbol i multikulturalizmit dhe integritetit, duke shënuar një histori të re të Siçilisë.

Ajo që duhet kujtuar është se Siçilia ishte dikur një fortesë islame, për më shumë se 200 vite. Ndërmjet shekujve IX dhe XI, ishulli mesdhetar, kryeqyteti i së cilës është Palermo, ende mban pjesë të historisë islame, si fizikisht, ashtu edhe kulturalisht.

Imam i qytetit, Ahmad Abd Al Majid Macaluso, flet për këto fakte teksa shëtit në muzeun eremit të San Giovannit, duke treguar shenjat në mure ku shihen gravurat me motive islame.

Muzeu në fakt ka ende shtyllat ku vërehet "mihrab", një strukturë gjysmërrethore që tregon vendin ku mbahen ligjëratat dhe është drejtimi i faljes së namazit.

"Çdo kishë e këtij vendi dikur ishte xhami, e cila më parë ishte sinagogë, e para kësaj kishë, e para kësaj sërish xhami", shpjegon Macaluso. "Kjo është historia e Siçilisë".

Imam Macaluso mendon se këto tri simbole, si gdhendja e ajeteve të Kur'anit në Katedralen e Palermos, arkitektura arabo-normane që shihet gjithandej dhe kultura që është trashëguar me vite, ua bënë më të lehtë jetën emigrantëve që kanë gjetur shtëpi në ishull.

"Me të vërtetë, për muslimanët e vendeve të tjera Siçilia është një vend mikpritës, pasi vendi ka një prirje natyrale për t'i mirëpritur besimtarët e të tri feve monoteiste", thotë Macaluso.

"Siçilianët ndryshojnë nga pjesa tjetër e Evropës, pasi kanë një prirje natyrore ndaj diversitetit. Siçilianët kanë këtë prirje për botën islame në ADN-në e tyre".

Imami Sehab Uddin gjithashtu beson se ka mjaft dallim midis kulturave të Italisë veriore dhe jugore.

"Italia është si një ndërtesë apartamentesh", shpjegon ai. "Njerëzit në veri janë në katet e sipërme dhe nuk flasin me njerëzit në katet e poshtme (në jug). Njerëzit në veri, në qytete si Padova dhe Venecia, kanë frikë nga ne. Nëse përpiqem për t'u bërë atyre goftë dhe një pyetje, ata frikësohen

Ajo që duhet kujtuar është se Sicilia ishte dikur një fortesë islame, për më shumë se 200 vite. Ndërmjet shekujve IX dhe XI, ishulli mesdhetar, kryeqyteti i së cilës është Palermo, ende mban pjesë të historisë islame, si fizikisht, ashtu edhe kulturalisht.

prej meje. Nëse i pyes këtu në Siçili, ata më përgjigjen dhe më ndihmojnë menjëherë".

Patrizia Spallino, profesoreshë e gjuhës arabe dhe drejtoreshë në Departamentin e Studimeve Mesjetare në Universitetin e Palermos, shpjegon se arabishtja tuniziane që flitej në ishull mbi 1.000 vjet më parë është ende e dukshme në dialektin siçilian, madje edhe në shprehjet e përditshme.

Porti i mrekullueshëm i Palermos, Masala, vjen nga arabishtja që ka kuptimin Marsa Allah, apo porti i Zotit.

Ky ndikim mund të shihet edhe në fjalë të zakonshme siçiliane si "miskin",

Kisha "San Cataldo", Palermo me kupola të arkitekturës islame



që në gjuhën arabe do të thotë i varfër ose i pafat.

Megjithëse ky ndikim arab është i dukshëm për dikë që studion gjuhën dhe e njeh historinë, shpjegon Spallino, shumica e popullsisë nuk është në dijeni të këtyre lidhjeve.

Ajo që shumica e posedojnë është koncepti mesdhetar i mikpritjes.

"Ideja e mikpritjes, duke filluar me Greqinë dhe arabët dhe pastaj bizantinët ... është e shenjtë", thotë ajo. "Në vendet arabe, kur ju ftojnë në shtëpinë e tyre, ju përgatisin çaj, diçka për të ngrënë, e kjo është gjithashtu tipike siçiliane".

Por realiteti i kësaj mikpritjeje nuk ka qenë i njëjtë në të gjithë Italinë.

Gjatë viteve të fundit, Italia ka dëshmuar sulme të mëdha raciste ndaj emigrantëve – më e keqja që ndodhi vitin e kaluar ishte në qytetin qendror italian të Maceratës, ku një aspirant politik djathtist plagosi gjashtë afrikanë emigrantë.

Përveç këtyre sulmeve, ministri i Brendshëm Matteo Salvini, i është turrur ashpër emigracionit, madje duke bllokuar misionet e shpëtimit në Detin Mesdhe.

Një nga politikanët më të sinqertë kundër politikave anti-emigrante të Italisë ka qenë kryebashkiaku i Palermos, Leoluca Orlando.

"Ministri Salvini nuk është kundër muslimanëve, ministri Salvini nuk është kundër imigrantëve, ministri Salvini është kundër italianëve", thotë Orlando. "Ai është kundër kulturës sonë të mikpritjes, ai është kundër shpirtit tonë mesdhetar, ai është kundër historisë sonë".

Orlando, së bashku me kryetarët e bashkive të Napolit, Kalabrisë dhe Firences, u përleshën me Salvinin duke refuzuar Dekretin e Kontestuar të Sigurisë. Dekreti anulonte lejet e qëndrimit për arsye humanitare, duke i zëvendësuar ato me leje të shkurtra për incidente specifike si fatkeqësitë natyrore.

Qasja e mirëpritur e Orlando për imigracionin dhe multikulturalizmin mund të shihet në zyrën e tij. Ai mburret me një Kur'an 200-vjeçar të cilin e ka dhuratë.

Letrat arabe dhe franceze mbi të drejtat e emigrantëve gjenden të vendosura me delikatesë e me rregull në një cep të tavolinës së tij.

"Kur dikush pyet se sa emigrantë janë në Palermo, unë nuk jap shifra", shpjegon Orlando. "Nuk jap shifra pasi ata janë njerëzit tanë", thotë ai. Kryetari i bashkisë së Palermos nuk bën dallim mes atyre që kanë lindur në Palermo dhe atyre që jetojnë në Palermo.

Orlando lidh perspektivën e tij mbi imigracionin dhe politikën e tij në kulturën dhe historinë e qytetit.

"Në jug të Italisë, në veçanti, ne nuk jemi edhe aq evropianë. Më vjen keq të ju them, por Palermo nuk është Frankfurt apo Berlin. Palermo nuk është Paris ... Palermo është Bejrut, Palermo është Stamboll, Palermo është Jeruzalem, Palermo është Tripoli, Palermo është një qytet i Lindjes së Mesme në Evropë. Mesdheu nuk është thjesht det, është një kontinent... është multikulturor", përfundon në mënyrën më të bukur historinë mijra vjeçare të larmisë kulturore, i pari i qytetit.

Përgatiti: **Arbnora Avdiu-Hoxha**
www.tesheshi.com

KËSHILLA TË SHEK. XVII PREJ NJË KORÇARI TE MENÇUR E QË VLEJNË EDHE SOT PËR SHQIPTARËT

Dr. Ardian Muhaj, *historian*

Ka shumë shqiptarë që nuk ia kanë dëgjuar emrin shqiptarit të madh, korçarit Koçi Bej. Syrja Vlora thotë me të drejtë se ishte nga të rrallët burra shqiptarë që ka lënë provat e gjalla të kuptimplota për organizimin e një shoqërie të mbështetur në një moral shtetnor të bazuar në drejtësinë dhe lirinë vetjake të njeriut. Koçi Bej është shembulli i shqiptarit dhe intelektualit që e ka thënë fjalën e drejtë përballë sundimtarit të padrejtë, ka fol me guxim përballë pushtetarit të dhunshëm, duke e vendosë veten vetëdijshëm në rrezik. Para katër shekujsh Koçi beu një nga mendjet më të ndritura shqiptare, i mbiquajtur Montesckjeja i Lindjes në traktatin e njohur të tij mbi shkaqet e krizave dhe mirëqeverisjen që në fakt i drejtohej personalisht sulltan Muratit IV, një nga më të dhunshmit e historisë osmane, shprehej me guxim të paimagjinueshëm për ne sot.

I përkujton sulltanit pasojat e rënda që sundimi arbitrar ka për shtetin dhe shoqërinë. Guxon madje të kritikojë korruptimin e thellë të elitës së trupës ushtarake, atë të jeniçerëve. Më pas thekson rëndësinë themelore që ka sistemi i drejtësisë dhe domosdoshmërinë e funksionimit të saj e pandikuar nga pushteti. Gjykatësi duhet të vendosë i lirë dhe i pandikuar prej askujt, thotë korçari i mençur. Pra, që para 4 shekujsh ai kërkonte pavarësinë e pushtetit gjyqësor nga çdo pushtet tjetër, gjë e cila padyshim që do e ngelte në klasë "reformën" e sotme në drejtësinë shqiptare të dirigjuar nga pushteti ekzekutiv. Ja tri këshilla që vlejnë edhe sot:

- "Për padrejtësinë që u bëhet shtetasve në një vend, në Ditën e Gjykimit, kanë për t'u përgjigjur sundimtarët dhe jo ministrat e tij. Nuk mundet të shfajësohet mbreti përpara Zotit se këtë punë ua kam lënë në dorë vartësve".

- "Bota mundet të qëndrojë në këmbë e të zhvillohet edhe me ata që nuk besojnë drejtë, por jo mbi padrejtësinë".

- "Drejtësia ndaj shtetasve ia zgjat jetën në pushtet sundimtarit".

REPUBLIKA E LIBANIT

Në vazhdim të shkrimeve për vendet Islame, dhe më specifikisht, për vendet e Shamit, sot do të njihemi me një profil të përmblendhur të Libanit.

Ky vend, i njohur zyrtarisht si Republika e Libanit, është një nga katër shtetet që përbëjnë Levantin - Shamin e bekuar.

katër rajone të mëdha fiziko-geografike: Rrafshina Bregdetare, Vargmali Perëndimor, Lugina Beka', dhe Vargmali Lindor.

Rrafshina Bregdetare shtrihet përgjatë bregdetit të vendit dhe konsiston në një rrafshinë të ngushtë dhe të ndërprerë, që vjen nga kufiri sirian në veri, pastaj zgjerohet për të

Juglindore. Lugina Beka' është 180 km e gjatë, dhe 10 deri në 26 km e gjerë. Toka e saj pjellore është e përbërë nga depozitimet lymore.

Vargmali Lindor i Libanit shtrihet paralelisht me Vargmalin Perëndimor dhe maja më e lartë e tij gjendet në malin Hermon, që arrin deri në 2.814 metra mbi nivelin e detit.

Nga Malet e Libanit zbresin rrëqe sezonale dhe lumenj, ku më i gjati ndër ta është lumi Litani, i cili arrin deri në rreth 170 kilometra. Ky lum del nga disa burime që gjenden në zonën rreth 10 km në perëndim të qytetit Bealbek, pastaj vazhdon rrugën e tij nëpër luginën Beka', në perëndim të Bealbekit dhe derdhet në Detin Mesdhe, në veri të qytetit të lashtë bregdetar, Sur (Tyre).

KLIMA

Libani ka një klimë të moderuar mesdhetare. Në zonat bregdetare, dimri është përgjithësisht i ftohtë dhe me shi, ndërsa vera është e nxehtë dhe e lagësht. Në zonat më të larta të vendit, temperaturat zakonisht bien nën zero, gjatë dimrit, me prani të madhe të borës. Majat e larta të maleve vazhdojnë të qëndrojnë mbuluar me borë deri në fillim të verës. Shumica e Libanit merr një sasi relativisht të madhe të reshjeve të shiut në krahasim me zonat e thata që e rrethojnë, megjithatë, disa zona në Libanin verilindor, marrin pak reshje, për shkak të pengesës së krijuar nga majat e larta të Maleve Perëndimore.

POPULLSIA, GJUHA DHE FEJA

Republika e Libanit përbëhet nga shumë sekte, raca dhe civilizime, gjë e cila e dallon atë nga shtetet e tjera arabe. Etnikisht, libanezët përbëjnë një përzierje në të cilën elementet fenikase, greke, armene dhe arabe janë të dallueshme, përveç pakicave etnike, përmend këtu ato armene dhe kurde. Popullsia e vendit llogaritet të shkojë në më shumë se 6 milion banorë, nga të cilët 95% janë arabë.¹

Gjuha zyrtare e folur në Liban është gjuha Arabe. Pastaj, për shkak të pakicave etnike, aty gjejmë edhe armenë-folës ose kurdë-folës. Gjuha Frënge dhe Angleze fliten gjerësisht, gjithashtu. Në disa nga kishat e maronitëve (katolikët

1. <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/le.html>

XHAMIA EL-OMERI, BEJRUT



Fjala "Liban", do të thotë "bardhësi". Sipas shumicës së historianëve, vendi e ka marrë këtë emër për shkak të bardhësisë së borës e cila është e pranishme përgjatë një pjesë të madhe të vitit, mbi majat e maleve të Libanit. Gjithashtu, ky emër qëndron edhe për shkak të shkëmbinjve të maleve të Libanit, të cilët kanë përbërje gëlqerore dhe që reflektojnë bardhësi. Në shkrimet e vjetra thuhet se, kur e shikoje Libanin nga deti i Mesdheut, binte në sy bardhësia e borës dhe bardhësia e shkëmbinjve të maleve të këtij vendi, prandaj merret me mend se përse ai vend, që në kohët e lashta, u quajt me këtë emër: Liban - Bardhësi.

Për bukurinë natyrore që ka, Libani është quajtur Zvicra e Lindjes së Mesme.

Republika e Libanit, në veri dhe në lindje, kufizohet me Sirinë, në jug kufizohet me Palestinën heroike, ndërsa në anën perëndimore, laget nga deti Mesdhe. Sipërfaqja e vendit llogaritet të jetë rreth 10.452 km². Kryeqyteti i vendit është Bejruti.

Libani është i ndarë kryesisht në

formuar rrafshinën Akkar dhe vazhdon deri në Ras En-Nakura, në jug, në kufi me Palestinën e pushtuar.

Vargmali Perëndimor i Libanit vijon paralelisht me bregdetin e Mesdheut, duke formuar kreshta gëlqerore dhe gur ranor dhe vazhdon në pjesën më të madhe të gjatësisë së vendit. Ky vargmal ndryshon për nga gjerësia, nga 10 deri në 56 km, dhe është i gdhendur nga gryka të ngushta dhe të thella. Maja më e lartë e këtij vargmali arrin deri në 3,088 metra mbi nivelin e detit, në Kurnat Es-Sauda, në veri të Libanit. Lartësia e këtij vargmali vjen duke zbritur gradualisht, kur vjen poshtë drejt jugut dhe pastaj vazhdon të lartësohet përsëri, deri në një lartësi prej 2.695 metrash, në malin Sannin, në perëndim të Libanit.

Lugina e Beka'-s është e pozicionuar mes vargmalit Lindor dhe Vargmalit Perëndimor. Kjo luginë është vazhdim i Luginës së Çarjes së Madhe, që është një hendek i vazhdueshëm geografik, prej rreth 6.000 kilometrash gjatësi, i cili shkon nga Lugina e Beka' e Libanit në Azi, deri në Mozambik, në Afrikën

romakë që ndjekin ritin lindor), përdoret gjuha Siriane.

Pjesa më e madhe e popullsisë së Libanit i përkasin besimit Islam, me rreth afërsisht 58%. Komuniteti i dytë më i madh fetar janë komuniteti i krishterë Maronit, ndërsa komuniteti Ortodoks Grek, është komuniteti i dytë më i madh i krishterë në vend. Në Liban gjendet gjithashtu një pakicë shumë e vogël hebreje.

NJË SHIKIM I SHKURTËR HISTORIK

Historia e Libanit është e lashtë sa vetë njerëzimi. Si të gjitha vendet e Lindjes së Mesme, Libani përmendet në gjetjet më të vjetra arkeologjike në rajon. Vendndodhja e tij geografike, në një udhëkryq që lidh Kontinentin e Azisë me vendet e Mesdheut, bëri që Libani të ketë një karakter të larmishëm të kulturës dhe të civilizimit.

Libani kaloi nëpër periudha të ndryshme historike, ku shumë sundimtarë, zëvendësuan atje njëri-tjetrin. Në fillimet e hershme parahistorike, Libani ka qenë vendbanim i kenanitëve dhe i fenikasve të lashtë, të cilët konsiderohen të parët që u vendosën në ato toka dhe qytetërimi i tyre vazhdoi të ishte i begatë për 2500 vjet. Pastaj më vonë, njëri pas tjetrit, aty erdhën edhe asirianët, persët, grekët, romakët, arabët, pastaj edhe kryqtarët, pastaj osmanët, ... për të rënë pastaj më në fund, nën kolonializmin francez.

Për shkak të qytetërimeve të njëpasnjëshme që e pushtuan vendin, shumë libanezë janë me origjinë franceze, turke, romake, ose evropiane në përgjithësi.

ISLAMI NË LIBAN

Islami erdhi në Liban qysh në vitin 636, pra në të njëjtën kohë me të gjitha vendet e Shamit. Kur muslimanët erdhën në ato vise, sistemi romak u zëvendësua me sistemin e ri islam. Gjuha Arabe dhe Islami dominuan në të gjithë Shamin, dhe dalëngadalë popullsia hyri në fenë e re, në fenë e mëshirës.

Qytetërimi Islam vazhdoi të dominonte në Liban, që nga Kalifët Rashidinë (636), pastaj vazhdoi me Kalifatin Umejad (që nga viti 661), pastaj me Kalifatin Abasid (që nga viti 750). Pas rënies së Kalifatit Abasid, Libani hyri nën sundimin e Perandorisë Osmane, në të njëjtën kohë me gjithë zonën e Shamit. Kjo ndodhi pas betejës së Merexh Dabik, me 8 gusht 1516, në kohën e Selimit I.

Osmanët qëndruan në Liban për katërqind vite, kohë gjatë së cilës ata

vendosën atje një sistem ushtarak, administrativ dhe social, duke e organizuar dhe përmirësuar kështu jetesën në Liban.

PASHKO VASË SHKODRANI

Një fakt interesant është se në një periudhë kohe, gjatë sundimit të perandorisë Osmane, Guvernator i Libanit u caktua shqiptari Pashko Vasë Shkodrani, i lindur dhe i edukuar në Shkodër. Ai ishte një i ri mjaft ambicioz, i cili kishte mësuar si autodidakt disa gjuhë të huaja, gjë e cila ia kishte



mundësuar hapjen ndaj kulturave të zhvilluara të kohës. Duke qenë një njeri i kulturuar, atij iu krijua mundësia të kishte poste të larta në epokën e Perandorisë Osmane. Posti i fundit i lartë i tij, ishte emërimi si Guvernator i Libanit.

Gjatë mandatit të tij, Pashko Vasa udhëhoqi me vendosmëri, integritet dhe me drejtësi. Ai ishte njeri i reformës, i gatshëm për të punuar në shërbim të përmirësimit të jetesës në zonën ku ishte guvernator. Pashko Vasa u konsiderua mbrojtës i autonomisë dhe i dinjitetit të qytetarëve të Libanit. Ai nuk i lejoi konsujt e shteteve të huaja, që të ndërhyjnë në punët e këtij vendi. Ai ishte besnik i sinqertë ndaj Sulltanit dhe qeverisë Osmane. Nën mandatin e tij u bënë një numër veprash arkitektonike. Ai ndërtoi një spital në Beit Ed-Din; ndërtoi një saraj në Abda, të cilin e bëri qendër dimërore; ndërtoi sarajin e Zahla-s, sarajin Xhuvajna, hapi rrugë dhe ndërtoi ura, dhe ishte i pari qeveritar në Liban, që u interesua për kërkimet

arkeologjike.²

Pashko Vasa qëndroi në postin e tij, si Guvernator i Libanit, që nga viti 1883, e derisa ndërroi jetë pas një beteje të gjatë me sëmundjen, me 29 Qershor të vitit 1892. Atë kohë ai u varros në Liban, në varrezat Hazimijeh, në Bejrut. Me rastin e njëqind vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, në vitin 1978, eshtrat e tij u sollën në atdhe, dhe tani ato prehen në Varrezat e Dëshmorëve, në qytetin e Shkodrës.

PAVARËSIA E LIBANIT

2. <https://www.marefa.org>


Pas luftës së parë botërore dhe me rënien e perandorisë Osmane, Libani hyri nën sundimin e Francës. Me 1 shtator 1926, nën Mandatin Francez, u formua Republika Libaneze. Në vitin 1943, Libani fitoi pavarësinë nga Franca, ndërsa ndërkombëtarisht, si një shtet i pavarur, u njoh në vitin 1944. Tërheqja përfundimtare e të gjitha trupave franceze nga territori libanez, u bë në vitin 1946.

Libanezët e festojnë ditën e pavarësisë me 22 Nëntor, duke iu referuar përfundimit të Mandatit Francez të vitit 1943, pavarësisht se largimi i plotë i trupave franceze nga vendi ndodhi me 31 Dhjetor të vitit 1946.

Historia e Libanit, që nga pavarësia e deri në ditët tona, është karakterizuar nga kaosi dhe nga mungesa e stabilitetit politik. Ky vend ka kaluar periudha shumë të vështira në historinë e tij, gjë e cila i inkurajoi shumë libanezë të emigronin jashtë vendit.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe



Prof. dr. Njazi Kazazi,
Didakt i Gjuhës Shqipe

Hafiz Ali Korça¹ - Drejtor Arsimit, Kryemyfti, publicist, shkrimtar dhe poet.

HYRJE:

“Hafiz Ali Korça i përket atij brezi ideologësh e organizatorësh, që më veprimtarinë e tyre i bënë një sherbim të denjë çështjes së zgjimit dhe bashkimit kombëtar, çështjes së tërësisë dhe pavarësisë së Atdheut dhe çështjes së përparimit të kombit”.²

“Midis hoxhallarëve të përndjekur nga pushtuesit, nga fanatikët dhe komunizmi për idetë, pikëpamjet dhe veprimarinë e tyre është edhe Hafiz

1. Marrë nga encilopedia “100 PËRSONALITE SHQIPTARË TË KULTURËS ISLAME” Shekulli XIX-XX Editor Genti Kruja, Andrin Rasha. Tiranë, 2012, fq. 24-27.

2. Po aty, fq. 24.



AFABETI LATIN NË ABETAREN E HAFIZ ALI KORÇËS

Ali Korça”, shkruan Prof. as. Dr. Ramiz Zeka në librin e tij: “Zhvillimi i kulturës Islame të shqiptarët gjatë shekullit XX”, Ribotim, Tiranë, 2002, dhe vazhdon “... i rritur në një mjedis patriotik, fetar e kulturor korçar të pastër, ai u brumos me bindje dhe parime, që e ngriten lart emrin e tij”.³

PAK NGA JETA:

Sipas të dhënave Hafiz Ali Korça u lind në Korçë me 5 prill 1873.⁴ Rridhte prej një familjeje të njohur intelektuale fetare. Në një mjedis të këtillë entusiast, Hafiz Aliu kreu arsimin fillor dhe në moshën 12-vjeare u bë Hafiz Kur’ani. Ky qe hapi i parë i celi shtigjet e jetes për arsimimin Ilam. Po në Korçë mbaroi shkollën e mesme (idadijen), kurse studimet e larta i vazhdoi në Universitetin e Stambollit.

Me përkushtim të madh mësoi gjuhen arabe dhe perse, ndërsa gjuhën turke e kishte përsosur që heret gjatë shkollimit në Korçë. Po në këtë qytet pëvehtësoi edhe gjuhën frengje që i mundësoi njohjen me klasikët fracezë.

“Më 1914 emërohet këshilltar i Ministrisë së Arsimit dhe dy vjet më vonë e shohim drejtor të arsimit që përfshinte një rajon të gjërë: Durrësin, Elbasanin, Dibrën, Matin dhe Pogradecin.

Gjatë vitit 1916 emërohet kryemyfti në Këshillin e Naltë të Sheriatit në Shkodër. Në këtë post ai zhvilloi aktivitetit e tij edhe në një fushë tjetër, në gjuhësi.”⁵

Hafiz Ali Korça ndërroi jetë më 31 dhjetor 1957, në moshë të thyer, në Kavajë, po aty u varros. Medreseja e Kavajës mban sot emrin e tij.

KRIJMTARIA LETRARE:

Hafiz Ali Korça, duke përkthyer kryeveprat si “Gjylstani”, “Rubairat” si dhe “Jusufi me Zelihanë”, i bëri të flasin në shqip poetët e mëdhej si Saadiun, O. Kajamin etj. siç la një kontribut të shquar me veprat origjinale në prozë

3. Hafiz Ali Korça (1874-1957) Shih: Sadik Bega, “Hfz. Ali Korça” në rev. “Kultura Islame” 1941/ Nr. 3-4, f. 102-107.

4. Prof. dr. Ismail Ahmeti: “Hafiz Ali Korça- Jeta dhe vepra”, vepra I, 2006, 102.

5. Marrë nga encilopedia “100 PËRSONALITE SHQIPTARË TË KULTURËS ISLAME” Shekulli XIX-XX Editor: Genti Kruja, Andrin Rasha. Tiranë, 2012, f. 24-27.

e poezi fetare dhe laike në një periudhë të gjatë kohore mes vitetve 1900-1942.

Duke folur për jetën e tij, autorët thonë se Hafiz Ali Korça bashkëpunoi me një varg figurash që luajten rol të rëndësishëm në historinë e kohës së re të Shqipërisë, siç janë: Kristo Luarasi, Jusuf Turabi Kërçova, Pandeli Sotiri, Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Mati Logoreci, Sali Nivica etj.



Kujtojmë se më 1925 botoi në Tiranë pamfletin “Bolshevizma a çkatërrimi i njerëzimit”, ku shprehu pikëpamjet e tij për komunizmin.

BOTIME TË HAFIZ ALI KORÇËS.

Prof. as. Dr. Zeka duke vazhduar thotë se ai na ka lënë një numër të konsiderueshëm veprash, në mes të cilave me një rëndësi të veçantë edhe tekstet shkollore, si: “Abetare shqip” (1910), “Fe- Rrëfenjësi, morali” (1914), “Gramtika, Sintaksa shqip-arabisht dhe fjalime” (1916) etj.

“ABETARE SHQIP” (1910):

Ne do të ndalemi pikërisht për këtë tekst, një një këndështrim të ri.⁶

Në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit XX, në prag të Pavësisë, forcat intelektuale shqiptare u angazhuan në nisma konkrete për krijimin e një shtetit të pavarur shqiptar me mësonjëtoreshë shqipe, tekste në gjuhën amtare, mësonjëtoreshë shqiptarë, alfabet të përbashkët.

Botimi i abetareve shqip ishte një ndër rrugët më konkrete dhe më popullore për realizimin e këtyre ideve.

Një nga autoritetet e kohës që mori

6. Shefik Osmani, Njazi Kazazi: “Abetaret shqipe dhe trajktoria e tyre historiko-pedagogjike”. Botim i MASH, Shtëpia botuese “Idromeno”, Tiranë, 2000, f. 366.

pjesë aktive në këto ndërmarrje që edhe Hafiz Ali Korça, i njohur si erudit, poliglot, mësues i “Mësonjëtoreshë së parë shqipe të Korçës”, (... “bashkëpunoi ngushtë me Pandeli Sotirin, drejtorin e kësaj shkolle... Aty dha pa pagesë Edukatën Islame.”⁷ përfaqësues i nacionalizmit shqiptar, i dënuar me vdekje për pikëpamet e tij.

“Botimi i një abetareje për mësimin e gjuhës shqipe me alfabetin latin nga një përfaqësues i klerokracisë myslimane ishte një sukses për çështjen kombetare, sepse dilte në mbrojtje të alfabeit të përbashkët dhe përjashonte përdorimin e alfabetave të tjera”⁸

Hafiz Ali Korça siç duket i njihte abetaret e deriathershme që nga Veqilharxhi, Mjeda, Gurakuqi, Boriçi, S. Frashëri, abetaret anonime etj. të botuara deri në atë kohë i ka parasysh dhe ndikohet prej tyre.

Hafiz Ali Korça u rradhiti në rradhët e ithtarëve të përdorimit të alfabetit latin. Me këtë alfabet ai botoi tekstin shkollor “Abetare”. (Shih frontespicin e librit në fjalë).

Abetarja, botuar më 1910, është shtypur në shypshkonjën “Korça” në Korçë, gjeti miratim të përgjithshëm në publik, sepse ishte në korent të lëvizjes arsimore-kulturore për afabetin shqip. Në këtë tekst autori përdori dy alfabetet: Alfabetin e Stambollit (variantin e vitit 1884) dhe alabetin e Kongrasit të Manastirit (1908). Kështu autori bëri i pari publikimin e këtij alfabeti në një abetare dhe është meritë e Hafiz Ali Korçës.

Po cila është përmbajtja e kësaj abetareje dhe nga ç’metodë niset ajo?

Kjo abetare nuk sjell ndonjë gjë të re. Ajo është e tipit të zakonshëm dhe i pëmbahet thuasë njëllor traditës së abetareve të mëparshme.

H. Ali Korça e ndërtoi abetaren e tij sipas metodës fonetike dhe e ndau lëndën në njësi mësimore, duke u mbështetur në renditjen alfabetike të shkronjave të vogla të shtypit. Në 17 njësi mësimore ajo bën objekt përvetësimin e 36 tinguj-shkronjave të gjuhës sonë. Çdo njësi mësimore është mjaft e ngarkuar, sepse numri i fonemave të përfshira në secilën është

7. Ramiz Zeka, “Zhvillimi i kulturës Islame te shqiptarët gjatë shekullit XX”, Ribotim, Tiranë, 2002, fq. 318

8. Shefik Osmani, Njazi Kazazi: “Abetaret shqipe dhe trajktoria e tyre historiko-pedagogjike”. Botim i MASH, Shtëpia botuese “Idromeno”, Tiranë, 2000, f. 366. Shih f.168-171, f. 168.



Vlerat e kësaj abetareje janë të veçanta sepse është i pari ndër shqiptarë, autorë të Abetareve shqipe që ka botuar një tekst me Alfabetin e Kongresit të Manastirit, 1908. Hafiz Ali Korça, vëshdon punën e filluar rreth 50 vjet më parë H. Daut Boriçi, më 1861, që hyri si atdhetar, didakt, tekstolog dhe si organizator i arsimit popullor

8-9, por ato rimerren në mësimet në vazhdim, me qëllim që të përvetësoën sa më mirë.

Copat e leximit që vijnë menjëherë pas pjesës së shkronjave, janë të gjitha në prozë. Ato përshkohen nga edukimi moral dhe janë të lidhura me problemet e jetës së përditshme dhe synojë të edukojnë tek nxënësit të vetive të mira morale, si: dashurinë për Allahun (xh.sh.) mirësjelljen, dashurinë për prindërit dhe njëri-tjetrin etj. Fjalët e urta të nxjerra nga folkori popullor dhe që janë vendosur në fund të tekstit, ia vlerat edukative të tij.

Përmbajtja e disa pjesëve ndonëse është e vështirë për moshat e mitura, por mendojmë se autori e ka bërë edhe moshat e rrituara, që kishin nevojë edhe ato për një tekst të tillë dhe u ka shërbyer edhe të rriturve.

Botimi i kësaj abetareje përbën një kontribut të madh në kushtet e pushtimit, mungesës së librave në gjuhën shqipe, në preg të Pavarësisë. Teksti ka përmbatje pa asnjë dallim fetar, gjë që përçon platformën e rilindësve në planin e edukimit atdhetar dhe arsimor.

Abetarja ka një vëllim të konsiderueshëm dhe shërbeu për disa vite me radhë për mësimin e lexim-shkrimit e gjuhës shqipe nga masat e popullit.

Ndryshe nga shumë abetare të tjera, mësimi i shkronjave të dorës jepet në fund të tekstit. Këtu jepet edhe një pasqyrë përmbledhëse e tyre, me shkronja të vogla e të mëdha, përkatësisht sipas dy alfabeve të përdorura në abetare.

PËRFUNDIME:

Vlerat e kësaj abetareje janë të veçanta sepse është i pari ndër shqiptarë, autorë të Abetareve shqipe që ka botuar një tekst me Alfabetin e Kongresit të Manastirit, 1908. Hafiz Ali Korça, vëshdon punën e filluar rreth 50 vjet më parë H. Daut Boriçi, më 1861, që hyri si atdhetar, didakt, tekstolog dhe si organizator i arsimit popullor dhe zë vend të nderuar në rreth 220 abetaret të botuara në gjithë historinë e abetareve shqipe, brenda dhe jashtë vendit, si: në Bukuresht, Stamboll, Bruksel, Sofje, Vjenë, Napoli, Selanik, Athinë, Paris, Milano, Bari, Worcester, Laipci, Konstancë, Aleksandri të Egjiptit.

DRITË E SHPRESË... QERSHOR 2019

NJË DITË E MBUSHUR ME DRITË E SHPRESË...

"Mësoni për farefisn tuaj, që të ruani lidhjet, sepse ruajtja e lidhjeve farefisnore është dashuri në familje, begati në pasuri, jetëgjatësi!"

Një hadith i mrekullueshëm, që trajtova sot me pjesëmarrësit në kampin veror të shoqatës "Ardhmëria", në Postribë, gjatë një këshille prindërore, të shoqëruar edhe me një bashkëbisedim të mbushur me shumë elementë të dëshmive të vështirimeve, besimit dhe vrullit të një moshe, që ka gjetur mbështetje në një zemër të madhe!

Një atmosferë e mrekullueshme, rrethuar nga paqtimi, në mesin e një brezi të ri, që falë Zotit, rritet sot i lirë për t'u edukuar natyrshëm me besim e moral, me edukatë e disiplinë, me dashuri për fenë dhe atdhenë, me besimin e fenë e gjyshërve e baballarëve, që as sistemi i faraonit e ithtarëve të tij besnikë që e pasuan, nuk i ktheu nga rrugëtimi shekullor në kërkim të pëlqimit të All-llahut, nëpërmjet dëshmimit si muslimanë!

Ky brez, nëse do të jemi të vëmendshëm për t'ia bërë fenë të dashur, duke ia lexuar bukur e drejtë, duke ia komentuar pa komplekse e sforcime, duke ia dëshmuar me sjellje e moral; patjetër që do të jetë një garanci e madhe dhe një bekim i pamohueshëm për vendin, për shoqërinë, për familjen!

Angazhimi me këtë brez të ri; përkudësja

ndaj tyre, ndjekja në vazhdimësi me një vështrim të urtë e largpamës prindëror, mbështetja e përkrahja në çdo hap të jetës, është në të vërtetë dëshmimi më i mirë që mund t'i bëjmë traditës së fortë të Resulull-llahut (a.s.), para duarve të cilit u edukuan një numër i madh djemsh të rinj, që e pasuan qysh të vegjël dhe nuk u ndanë më prej tij, as me kalimin nga kjo botë!

Përkujdesi për brezin e ri dhe investimi për edukimin e tij me moralin e besimit dhe të fesë, duhet të jetë ndër prioritetet e angazhimeve tona, duke mos u ndalur tek pragu i demagogjisë së askujt!

Sot, teksa po bashkëbisedoja me këta fëmijë të mirë të familjeve të mira e besimtare të Postribës, u mbusha me energji pozitive e dashni, sikurse u luta që All-llahu i Madhëruar t'i mbrojë nga çdo e keqe; nga humbja e kohës, nga vrasja e lirisë, nga neglizhenca në hak të edukimit të tyre, nga sprovat e realiteteve të hirta ku është përmbysur vendi, nga kriza e moralit, nga mbytja e mendimit, nga papjekuria në leximin e teksteve të fesë, nga predikues të nxituar e në marrëdhënie të izoluar me botën e jetën, nga rutina e një jete të lënë pas dore, por që vazhdon të shpresojë e, mbështetur në kufirin e besimit, të vështrojë drejt një të ardhmeje më të paqte e më me dritë..!

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, 25 qershor 2019



Ditën e martë, më 4 qershor 2019, që në mëngjes herët, xhamitë e Shkodrës u mbushën me besimtarë dhe besimtare të shumtë, të cilët vinin për të kryer faljen e namazit të sabahut dhe Fitër Bajramit.

Sipas programit të publikuar më parë, ceremonia kryesore e Fitër Bajramit u zhvillua në xhaminë “Ebu Bekër” dhe xhaminë e Parrucës.

Pas faljes së namazit të sahabut, filluan ligjëratat e rastit, ku ligjëruan në xhaminë “Ebu Bekër” H. Gilman Kazazi dhe teologu Arben Halluni, ndërsa hytben e mbajti H. Idmir Plaku, në xhaminë e Parrucës, H. Lavdrim Hamja dhe H. Naim Drijaj, ndërsa hytben e mbajti H. Durim Kasemi.

Hoxhallarët e nderuar në ligjëratat e tyre hodhën dritë mbi parimet islame dhe mesazhet universale të Kur’anit Famëllartë dhe Traditës Profetike, duke shpjeguar me korrektësi këto parime dhe mesazhe hyjnore.

FITËR BAJRAMI FESTOHET ME MADHËSHTI NË SHKODËR



Imamët e nderuar, përmes ligjëratave të tyre dhanë këshilla me vlerë dhe porosi të vyera për besimtarët e shumtë, të cilët ishin të pranishëm, por edhe për teleshikuesit, të cilët patën mundësi ta ndiqnin ceremoninë e kësaj

feste madhështore përmes ekraneve të televizionit dhe rrjeteve sociale.

Për shkak të kushteve jo të qëndrueshme të motit, falja e namazit të Fitër Bajramit këtë vit u bë nëpër xhamia dhe jo në shesh, siç është bërë traditë.



MIQ DHE VIZITORË UROJNË FESTËN E FITËR BAJRAMIT

Ditën e parë të Fitër Bajramit, të martën, më 4 qershor 2019, pas kryerjes së ceremonisë dhe faljes së Fitër Bajramit në xhamitë e qytetit, Myftinia Shkodër organizoi pritjen tradicionale të miqve dhe vizitorëve, me rastin e kësaj feste të begatë për mbarë besimtarët myslimanë.

Pritja tradicionale me këtë rast u zhvillua në ambientet e xhamisë së Parrucës, ku miq dhe vizitorë të shumtë, duke nisur nga drejtuesit më të lartë të institucioneve fetare të Shkodrës, drejtues të institucioneve vendore e lokale, deputetë, intelektualë dhe besimtarë të shumtë, vinin për të uruar festën e Fitër Bajramit.

Përmes bisedave të ngrohta, miqtë dhe vizitorët e shumtë shprehën urimet e ngrohta dhe lutjet e tyre, që Zoti ta



pranojë agjërimin dhe adhurimet e gjithë besimtarëve, e t’u japë mirësi e begati Shkodrës dhe mbarë Shqipërisë.

Pritje tradicionale me rastin e festave të ndryshme fetare, nxjerr në pah vlerën

e harmonisë dhe bashkëjetesës fetare, si një gjurmë e traditës së respektimit të fesë së tjetrit, veçanërisht në këto ditë, kur mbarë bota islame gëzon dhe feston Fitër Bajramin.

Dokumentari për klerikun e shquar shkodran Hafiz Ali Kraja, “Kryet nalt”, i realizuar nga Fondacioni kujto.al – Arkiva Online e Krimeve dhe Viktimave të Komunizmit në Shqipëri dhe Luljeta Progni është shfaqur për herë të parë premierë mbrëmjen e djeshme në Kinema Millennium në Shkodër.

Dokumentari kushtuar klerikut të shquar Hafiz Ali Kraja tregon kalvarin e gjatë të persekutimeve që nga internimi prej fashistëve italianë, përndjekja ndaj tij dhe familjes prej komunistëve dhe vuajtjet për 18 vjet në kampet e punës e burgun e Burrelit.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, myftiu i Shkodrës, z. Muhamed Sytari, kryetarja e Bashkisë së Shkodrës, znj. Voltana Ademi, themeluesi i Fondacioni Kujto, z. Agron Shehaj, personalitete, familjarë dhe të afërm të Hafiz Ali Krajës.

Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu në fjalën e tij u shpreh se ky dokumentar i dedikohet një personaliteti që nuk i përket thjesht një komuniteti apo një qyteti. Dijetari, hoxha, mësuesi, aktivisti politik e atdhetari i madh Hafiz Ali kraja, me jetën dhe veprën e tij bën krenar gjithë Shqipërinë dhe shqiptarët.

“Hafiz Ali Kraja, ish një burrë i mençur, fisnik, optimist, i qeshur dhe me kulturë të madhe fetare. Ai ishte një burrë që nuk bëri kurrë kompromise, pavarësisht jetës së tij të trazuar e

“KRYET NALT”, SHFAQET DOKUMENTARI PËR DIJETARIN HAFIZ ALI KRAJA



presioneve të shumta, ai qëndroi stoik në parimet e tij fetare dhe kombëtare, këtë e dallojmë fare mirë kur shfetojmë shënimet e tij ku thuhet: “I jap llogari, më parë, të lumit Zot, gjyqi i Tij asht ma i randsishmi!” dhe: “Jam kryenaltë që jam mundue me krye misionin fetar e kombëtar për sa kam mujtë. Lus Zotin të më falë për mungesat që mund të kem ba në kryemjen e këtij misioni”, tha ndër të tjera kreu i KMSH-së.

Themeluesi i Fondacioni Kujto, Agron Shehaj, u shpreh se fatkeqësisht një pjesë e madhe e shoqërisë kërkon të mos shohë, ose më keq, të mohojë krimet e komunizmit. “Në fakt, mohuesi kryesor

i krimeve të komunizmit është pikërisht shteti, dhe për të kuptuar këtë, mjafton të shohësh librat shkollorë që nuk kanë asnjë fjali për krimet e komunizmit. Në këto kushte i takon shoqërisë civile, njerëzve të thjeshtë të bëjnë sa më shumë që viktimat e regjimit komunist mos të harrohen, dhe fondacioni kujto dhe cikli i dokumentarëve ka pikërisht këtë qëllim”, tha Shehaj.

Kryetarja e Bashkisë së Shkodrës, Voltana Ademi tha se Hafuz Ali Kraja është pjesë e trashëgimisë së madhe të Shkodrës dhe ende sot mes banorëve të saj kujtohet kleriku i ditur.

(www.kmsh.al)

MYFTIU TAKOI IMAMËT NË PRAG TË SEZONIT TË HAXHIT 1440

Paraditën e së enjtes, më 13 qershor 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me një grup imamësh të qytetit dhe fshatit.

Në qendër të vëmendjes ishte sezoni i ri i Haxhit 1440, udhëzimet për regjistrimet e fundit, si dhe shfrytëzimi i kohës dhe mundësive për kurset verore dhe aktivitetet e larmishme të rinisë islame.

Myftiu udhëzoi që e xhumaja e nesërme të jetë e unifikuar në të gjitha xhamitë e Shkodrës, duke u përqendruar tek vlerat dhe dobietë e haxhit, si një ndër pesë shtyllat kryesore të fesë islame.

Më pas, teologu Lavdrim Hamja bëri një përmbledhje të aktivitetit të Ramazanit që sapo kaloi dhe falënderoi imamët për angazhimin e tyre dhe



përpjekjet përherë në rritje për të dëshmuar një muaj të mbushur me aktivitetet e përkushtim.

Po ashtu, teologu Arben Halluni, dha disa udhëzime dhe lajmërimet për aktivitetin e larmishëm të kurseve fetare

të xhamive tona, gjatë periudhës së verës.

Po ashtu, teologu Ervil Kuçi, sqaroi imamët në lidhje me projektet e sektorit të rinisë, për shfrytëzimin e periudhës verore dhe aktivizimin e rinisë muslimane shkodrane me aktivitete të dobishme.

Ditën e xhuma, më 14 qershor 2019, pas namazit të xhumasë, në oborrin e xhamisë së Parrucës, fondacioni “Mirësia” në bashkëpunim me Myftininë Shkodër, bëri të mundur shpërndarjen e 1.200 kopjeve të librit biografik mbi jetën e të dërguarit të All-llahut, Hz. Muhammedit (a.s.).

Besimtarët të shumtë, të cilët morën pjesë në faljen e xhumasë, por edhe kalimtarë të ndryshëm morën falës biografikë e plotë të të Dërguarit të All-llahut (a.s.), duke pasur kështu mundësinë të njihen me jetën e Profetit të fundit të njerëzisë dhe me moralin e tij të bukur, i cili u dërgua si mëshirë për mbarë botët dhe njëkohësisht shembulli më i përkryer për mbarë njerëzimin.

SHPËRNDAHET LIBRI ME VLERË MBI JETËN E HZ. MUHAMMEDIT (A.S.)



Me këtë rast, përshëndeti Imam Muhamed Muhamed B. Sytari, Myfti i Zonës Shkodër dhe z. Korab Kaja, drejtor i fondacionit “Mirësia”, të cilët shprehën edhe kënaqësinë e tyre për këtë aktivitet me dobi për qytetarët.

Projekti “Të njihemi me profetin Muhammed (a.s.)”, është një projekt i fondacionit “Rahma International Society”, Kuvajt, që zbatohet në Shqipëri përmes fondacionit “Mirësia”, që ka për program edhe shpërndarjen e 5.000 kopjeve të këtij botimi me vlerë.



U ZHVILLUA CEREMONIA E GURTHEMELIT TË XHAMISË SË RE NË KIRAS

Paraditën e së hënës, më 17 qershor 2019, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Shoqatën “Mirënjohja”, zhvilloi ceremoninë simbolike të gurthemelit të xhamisë së re në lagjen Kiras.

Ceremonia u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili theksoi se xhamia e re e Kirasit është një mundësi e re për banorët e lagjes dhe Myftininë e Shkodrës për zhvillimin e aktivitetit të saj të larmishëm në shërbim të qytetarëve.

Myftiu falënderoi kryetarin e Shoqatës “Mirënjohja”, z. Samed Shehu për kontributin dhe interesimin e vazhdueshëm për afrimin e donatorit nga Shteti i Kuvajtit.

“Kuvajti i vogël në hartë, por me kontribute të mëdha në humanizëm e bamirësi në çdo cep të botës, na ofron sot edhe këtë projekt të mrekullueshëm!”, tha Myftiu.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, që vlerësoi



këtë projekt të ri si shumë me dobi për besimtarët dhe njëkohësisht shprehu falënderimet e tij për kontributet kuvajtiane në Shqipëri në shumë drejtime.

Ceremonia u përshëndet edhe nga Kryetaria e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, e cila shprehu mbështetjen e saj për këtë projekt dinjitoz në shërbim të komunitetit në lagjen Kiras.

Njëkohësisht shprehu vlerësimet e saj për bashkëpunimin me Myftininë e Shkodrës gjatë këtyre viteve të drejtimit të saj të Bashkisë Shkodër.

Ceremonia vijoi me tekbirot, që i paraprinë hedhjes simbolike të gurthemelit të xhamisë së re, për të cilën ka nisur puna që para Ramazanit të sivjetshëm.

Ditën e martë, më 18 qershor 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar nga menaxheri i pronave në Myftininë e Shkodrës, z. Blendi Alushi, zhvilloi një takim pune në Zyrën e Vakf-Investimeve në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Në qendër të vëmendjes ishin problematikat ndër vite në vakëfet e paliruara ende në Rus, Kiras dhe Zdralej.

Drejtori i Zyrës së Vakf-Investimeve, z. Edison Hoti, dëgjoi me vëmendje për secilën dosje dhe mundësitë e zgjidhjes së secilës prej tyre, sikurse dha mendimet e tij dhe mundësitë e ndërhyrjes së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për zgjidhjen e situatave të krijuara.

Myftiu theksoi se zaptimi i vakëfit në Rus dhe moslirimi i deritanishëm ka penguar Myftininë Shkodër për realizimin e një projekti dinjitoz për lagjen e madhe

TAKIM PUNE PËR VAKËFET NË RUS, KIRAS E ZDRALEJ



muslimane të Shkodrës.

Njëkohësisht u diskutua edhe për disa çështje me rëndësi që lidhen

me mirëfunksionimin e vakëfeve dhe ndjekjen e secilës çështje me prioritet, për t'i vënë në funksionin këto prona.

“MËSOJMË DHE ARGËTOHEMI”, NIS PROGRAMI VEROR PËR FËMIJËT E KURSEVE FETARE

Ditën e mërkurë, më 19 qershor 2019 filloi programi veror për fëmijët e kurseve fetare të xhamive të Shkodrës.

Në ditën e parë të këtij programi, në pikën turistike të Razmës, morën pjesë fëmijët e xhamive të fshatit Dragoç dhe Kullaj të Postribës, së bashku me dy imamët e nderuar të tyre, H. Shkëlqim Sykaj dhe H. Ardin Selhani

Përgjegjësi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni bëri hapjen e këtij programi, duke i uruar mirëseardhjen fëmijëve dhe duke bërë prezantimin e këtij programi, që tashmë është kthyer në një traditë



të përvitshme. Teologu Halluni tha, se qëllimi i këtij programi është të mësojmë dhe në të njëjtën kohë të argëtohemi përmes aktiviteteve dhe lojërave të ndryshme.

Nisjen e këtij programi e përshëndeti edhe z. Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së “Dy Vajzave”, i cili i përgëzoji fëmijët për pjesëmarrjen e tyre në këtë program dhe u lut, që ata të përfitojnë sa më shumë prej këtyre aktiviteteve të dobishme dhe vlerë.

Programi “Mësojmë dhe argëtohemi” është parashikuar të zhvillohet në disa ditë të caktuara gjatë muajve qershor dhe korrik dhe do të përfshijë disa xhami të Myftinisë Shkodër.

MYFTIU LIGJËROI NË KAMPIN VEROR TË QENDRËS KULTURORE POSTRIBË

Paraditën e së martës, më 25 qershor 2019, me ftesë të Qendrës Kulturore Postribë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari mbajti një këshillë prindërore për frekuentuesit e kampit veror, që organizon Shoqata "Ardhmëria".

Fillimisht, Myftiu falënderoi imamin e xhamisë së fshatit Dragoç, z. Shkëlqim Sykaj dhe shoqatën "Ardhmëria" për këtë organizim me dobi për fëmijët dhe rininë e zonës Postribë.

Më pas, mbajti një ligjëratë me



këshilla të dobishme rreth vlerës së dijes dhe shfrytëzimit të kohës, sidomos në kohën e pushimeve verore.

Myftiu theksoi se prej mirësive më të mëdha, me të cilat është begatuar jeta e njeriut është edhe udhëzimi i tij drejt shfrytëzimit të kohës, për ta bërë atë mundësi lartësimi dhe ngritjeje në jetë.

Myftiu këshilloi të pranishmit që ta shfrytëzojnë kohën dhe të disiplinojnë në marrëdhënie me të, si dhe të shfrytëzojnë stinën e pushimeve për të ndjekur kurse të gjuhëve të huaja, për lexime të ndryshme, për mësimin e sureve të shkurtra dhe rregullat e adhurimeve të ndryshme, për shtimin e vizitave farefisnore, që nxisin afrimin dhe forcimin e familjes e farefisit, etj.

"MËSOJMË DHE ARGËTOHEMI" ME FËMIJËT E XHAMISË SË FSHATIT GOLEM DHE SHTOJ I VJETËR

Ditën e martë paradite, më 25 qershor 2019, sektori i arsimit pranë Myftinisë Shkodër organizoi aktivitetin e radhës të projektit "Mësojmë dhe argëtohem" me fëmijët e kurseve fetare të xhamisë së fshatit Golem dhe Shtoj i Vjetër.

Aktiviteti në fjalë u zhvillua në kompleksin "Zmijani" dhe u hap nga përgjegjësi i arsimit, teologu Arben Halluni, i cili pasi i njohu nxënësit me projektin u dha edhe një këshillë fetare rreth mirësive dhe begative të Islamit dhe rëndësisë që kanë kurset fetare dhe aktivitetet e ndryshme që zhvillohen me



nxënësit e këtyre kurseve.

Teologu Halluni falënderoi edhe dy imamët e nderuar H. Kujtim Cufaj dhe H. Hysen Muçaj, të cilët punojnë me përkushtim dhe pasion me fëmijët e dy xhamive përkatëse, xhamisë së fshatit Golem dhe xhamisë së fshatit Shtoj i Vjetër.

Projekti "Mësojmë dhe argëtohem" përbëhet nga këshilla të shkurtra, konkurse të vogla fetare, lojëra të ndryshme sportive dhe argëtuese.



EGIPT - PRESIDENTI I RRËZUAR MURSI VDES NË SALLËN E GJYQIT

Sipas televizionit shtetëror egjiptian ish-presidenti Mursi në fillim i kishte rënë të fikët në sallën e gjyqit dhe pastaj kishte vdekur.

Edhe mediat vendore raportojnë se gjatë seancës gjyqësore Mursi kishte kërkuar fjalën nga gjyqtari dhe kishte folur.

Mësohet se pas mbarimit të seancës gjyqësore, të datës 17 qershor 2019, Mursi i kishte rënë të fikët dhe pastaj ishte ndarë nga jeta.

Prokurori i Përgjithshëm i Egjiptit, Nebil Sadik në komunikatën me shkrim kishte deklaruar se ishin informuar mbi vdekjen e Mursit gjatë shqyrtimit të çështjes me numër 2013/56458 në seancë gjyqësore.

Mursi kishte humbur ndjenjat dhe



ishte rrëzuar në tokë, ndërsa ndodhej brenda kafazit të të pandehurve në sallën e gjyqit bashkë me të pandehurit e tjerë të çështjes. Pastaj ai ishte transportuar menjëherë në spital, ku kishte vdekur, thuhet në vijim të komunikatës me

shkrim që është lëshuar nga Zyra e Kryeprokurorit të Egjiptit.

Ish-presidenti i Egjiptit, Muhamed Mursi në vitin 2012 u bë kryetari i 5-të i dhe i pari i vendit, i ardhur në detyrë me zgjedhje.

Në 3 korrik 2013 Mursi u rrëzua me grushtin ushtarak të Forcave të Armatosura të Egjiptit të udhëhequr nga Sisi.

Kurse Mursi deklaroi se nuk e prante grushtin e shtetit dhe kishte bërë thirrje për rezistencë ndaj puçit ushtarak.

Pas grushtit të shtetit Mursi ishte arrestuar dhe gjykohej për 6 vite nën masën e sigurisë arrest në burg. Dihej që gjendja e tij shëndetësore vinte duke u përkeqësuar, në veçanti vitin e fundit.

(www.trt.net.tr/shqip)

SULM NDAJ NJË XHAMIE NË FRANCË

në spital për kurim zyrtarët e sigurisë e filluan hetimin.

Në deklaratën e bërë në lidhje me rastin në llogarinë e tij në media sociale, ministri i Punëve të Brendshme të Francës, Christophe Castaner nga prefektët kërkoi që t'i shtojnë masat e sigurisë në vendet e adhurimit në mbarë vendin.

(www.trt.net.tr/shqip)



GJERMANI – SULMI I 3-TË KUNDËR XHAMIVE NË 2 DITË

Në murin e xhamisë së Sulltan Ejupit në Kamen, një xhami që funksionon në varësi të Bashkësisë Islame Turke për Çështjet Fetare (DITIB) është parë të jetë shkruar "Shporruni!" dhe parulla raciste.

Kjo është xhamia e tretë në Gjermani në shënjestër të sulmeve brenda dy ditëve. Më parë ishin sulmuar xhamia Qendrore në Kasel të landit Hesën, si dhe xhamia në Bremen, ku ishin djegur libra të Kuranit.

Kryetari i shoqatës së Xhamisë së Sulltan Ejupit, Mustafa Kose (Köse) tha në një deklaratë se shprehjet dhe parullat raciste në

murin e xhamisë janë shkruar nga një grup i ekstremist të djathtë në të gdhirë të ditës së sotme.

Kose u shpreh i shqetësuar për numrin në rritje të sulmeve kundër xhamive këto ditë e fundit.

"Xhemati dhe punonjësit e çështjeve fetare janë të frikësuar dhe të shqetësuar. Ata mendojnë se këtej e tutje namazi në xhami duhet falur me dyer mbyllur. Ne nuk kemi probleme me askënd dhe me të gjithë kemi marrëdhënie të mira fqinjësore", - u shpreh ai.

Policia ka nisur hetimin e rastit, sqaroi Kose dhe kërkoi kapjen sa më shpejt të agresorit.

(www.trt.net.tr/shqip)



POLICIA E PATERSONIT MIRËPRET KLASËN E PARË TË FEMRAVE DHE POLICEN E PARË ME HIXHAB



Klasa e re e oficerëve të policisë së Patersonit në ShBA thyen një traditë historike si një klasë e re komplet femra, duke përfshirë bashkë me to dhe gruan e parë palestino – amerikane me mbulesë (hixhab).

Majori Andre Sayegh e quan “Moment krenarie për qytetin e Patersonit” betimin që bëjnë tre oficeret e reja, Yeniry Medina, Gabriela Toribio dhe Serein Tamimi, në ceremoninë që u zhvillua të martën në Bashkinë e qytetit.

“Ato janë gjurmueset”, tha Sayegh në momentin që prezantoi oficeret e reja. Ato thyen tavanin prej qelqi, tani patersonat e rinj, rinia në shkolla dhe rrugët tona mund të shikojnë lart dhe të thonë: “Unë vetëm dua të bëhem si ato!”.

Vajzat filluan në një klasë që përbëhej nga 6 veta rekrute të policisë së Patersonit, përfshirë 4 gra dhe 2 burra.

Pas një trajnimit rigoroz 6 mujor të atij fizik dhe akademik, këto 3 femra ishin ata që qëndruan deri në fund.

Serein Tamimi, 22 vjeçe e cila erdhi në Amerikë atëherë kur ishte më pak se një vitit, ku mori zhvillim në shkollë të mesme dhe më pas u rrit në studimet e drejtësisë në universitetin e shtetit të Montclair, dhe shkëlqeu në akademi.

Në ditën e martë, ajo u bë oficerja e parë e policisë që veshi hixhabin ose mbulesën islamike në qytet.

Ajo shpreson të inspirojë gratë e reja muslimane që të ndjekin ëndrrat e tyre, por gjithashtu të vendosë një shembull për amerikanët e tjerë, të cilët mund të mos dinë shumë rreth muslimanëve.

“Unë dua të jem aty për komunitetin dhe të jem në gjendje t’i lidh ata drejt një

kuptimi dhe të bëj që të gjithë ta dinë, nëse kanë nevojë për diçka, ata mund të bëjnë pyetje” - tha Tamimi, të cilës mamaja, motra dhe kushërira e saj e përgëzuan atë në audiencë.

“Unë dua t’u tregoj atyre që ne nuk jemi ata që media mundohet të na paraqesë, tha ajo. Ne jemi miqësore, ne dashurojmë atë që bëjmë dhe ne jemi atje për komunitetin.

Ndërsa Toribio dhe Medina janë domenikano – amerikane dhe kanë jetuar gjithë jetën e tyre në Paterson. Ata iu bashkuan forcave të policisë së bashku me 400 të tjerë ndër ta, 57 ishin gra.

Gabriela Toribio tha që ajo ishte inspiruar nga njohja me një polici të sjellshëm, i cili e kishte ndihmuar atë në fëmijëri dhe gjithashtu duke marrë shembull traditën e familjes së saj në polici.

“Unë doja të isha si ata dhe të bëja ndryshimin” - tha ajo.

Yeniry Medina është 27 vjeçe, ajo tha që iu bashkua departamentit të policisë sepse donte të ndihmonte komunitetin.

Unë jam lindur dhe rritur në Paterson - tha ajo dhe kjo është një mënyrë që t’ua shpërblej shoqërisë dhe familjes dhe të gjithë atyre që kanë rëndësi për mua.

Mesazhi i saj për vajzat e reja ishte: “Fokusohu dhe vazhdo rrugën tënde dhe domosdoshmërisht do të arrish tek qëllimi jot, nuk ka rëndësi se çfarë thonë njerëzit, ajo që ka rëndësi është që të vazhdosh rrugën që ke nisur”.

Gjatë ceremonisë, shefi i policisë Troy Oswald përgëzoi të tre vajzat për përpjekjet e tyre në akademi. Ai tha që ishte madhështore që qyteti i Patersonit



"E vërteta është, se gratë e përkushtuara në historinë tonë, asnjëherë nuk janë treguar dorështrenguar në pasuri e as në kohë në rrugën e Allahut. Ato kanë realizuar në heshtje, atë që shumë prej burrave nuk kanë mundur ta kryejnë.

Studiuesit mund të kërkojnë për to në barkun e historisë dhe t'i gjejnë emrat e tyre të harruara e të privuara nga publikimi, e ato tek Allahu kanë një pozitë të lartë, që nuk mund ta fitojë dikush tjetër, përveç tyre!"

Sheikh Muhamed El-Gazali

bëri historinë me oficeren e parë të policisë palestino-amerikane, por që kjo do të thotë se qyteti nuk do të fokusohet tek besimi ose veshja fetare e një oficeri apo oficerëve policie.

“Nuk është qëllimi tek ajo që veshim” - tha ai. “Nuk është në çfarë feje praktikojmë, është në aftësinë për të komunikuar, për të trajtuar të gjithë me drejtësi dhe të qenurit i një zëri etik”.

(www.northjersey.com)

Përktheu nga anglishtja:

Ervil Kuçi

AUSTRALIANËT MËSOJNË MË SHUMË RRETH ISLAMIT NË MUZEUN ISLAM



Muzeu Islam i Australisë që ndodhet në Melbourne ofron informacione mbi historinë, jetën dhe identitetin e muslimanëve në vend.

I themeluar nga biznesmeni australian Moustafa Fahour me mbështetjen e qeverisë federale australiane, muzeu është i pari dhe i vetmi muze islam në vend.

Që nga hapja në vitin 2014, muzeu është vizituar nga më shumë se 50.000

vizitorë.

Muzeu qëndron i hapur gjashtë ditë në javë, ndërsa organizon konferenca dhe ngjarje të ndryshme në fusha të ndryshme si kaligrafia, historia e artit, pikturat miniaturë, veprat artizanale, si dhe mbi ngjarjet aktuale.

“Ne duam që të përfetojnë dhe mësojnë për bukurinë e Islamit”, tha drejtoresha e muzeut, Maryum Chaudhry, në një intervistë për AA.

Chaudhry tha se vizitorët mund të mësojnë më shumë për historinë e Islamit në Australi dhe në botë, për shkencëtarët e mirënjohur muslimanë, kontributet e muslimanëve në Australi dhe konceptet themelore të Islamit.

Duke nënvizuar se kanë marrë reagime pozitive nga vizitorët nga Australia dhe nga vende të ndryshme të botës, ajo tha se shumica e vizitorëve nuk kanë njohuri paraprake mbi komunitetin musliman në vend.

“Njerëzit janë mjaft pozitivë për përvojën e tyre. Për shumë njerëz është hera e parë që kanë kontakt me komunitetin musliman”, tha Chaudhry.

“Ata u larguan me informacione të reja dhe u frymëzuan. Duan të mësojnë më shumë dhe të kthehen përsëri”, shtoi Chaudhry.

“Në ditën e sulmit terrorist në Christchurch të Zelandës së Re, shumë australianë erdhën në muze për herë të parë me lule në duart e tyre”, tha Chaudhry.

(www.radiojehona.al)

KËNGËTARJA AMERIKANE MILES PRANON ISLAMIN



Këngëtarja amerikane e konvertuar së fundmi në Islam, Della Miles, tha se veten e konsideron si foshnje në Islam.

Miles, një këngëtare e xhazit në SHBA, e cila ka punuar me yjet botërorë si Michael Jackson dhe Whitney Houston, në një prononcim për Anadolu Agency (AA) thotë se është konvertuar në Islam pasi ka kaluar një kohë në Turqi duke thënë se feja e “rrethoi” atë.

Duke nënvizuar se e gjeti përvojën muslimane të jetë shumë e fortë në Turqi,

Miles thotë se: “Edhe pse ekzistojnë muslimanë në Amerikë, prej nga jam edhe unë, nuk e kam ndjerë asnjëherë”. Ajo shprehu dashuri për Stambollin dhe kulturën turke, duke thënë se ka mësuar shumë për fenë në Turqi.

“Stambolli është vendi më i mirë për të marrë atmosferën e vërtetë të asaj që posedon Turqia”, shtoi ajo.

Për vuajtjet e popullit palestinez, Miles theksoi se artistët kanë përgjegjësi për të “bërë deklarata” kur ndodhin tragjedi.

“Ndiem përgjegjëse si qenie njerëzore për të mbështetur këdo që konsiderohet humbës dhe kush është në tragjedi”, tha Miles.

Përsa i përket të kuptuarit dhe përvojës së saj si muslimane, Miles tha: “Veprimet flasin më shumë se fjalët”.

“Kam parë muslimanë të cilët unë e di se pikërisht e heqin këmbishën nga shpina për t’ia dhënë diku në nevojë”, tha ajo.

Ajo lavdëroi popullin turk në këtë drejtim duke thënë: “Ata as që e dinë se kush jam por më bëjnë të ndihem shumë rehat”.

Më e reja nga gjashtë fëmijët, Miles lindi në një familje me tradita muzikore. Nëna e saj këndoi dhe drejtoi muzikë në kishë, ndërsa babai i saj ishte një entuziast i xhazit dhe pronar i një vendi muzikor.

Në vitin 2012, ajo mori një rol udhëheqës në operën amerikane Lulu dhe më vonë e portretizoi gruan e ish-presidentit të SHBA-ve Barak Obama në Hope – Story Musical Obama.

Miles gjithashtu ka punuar në albume tribute për muzikantët turq si Müslüm Gürses dhe Zeki Müren në Turqi.

(www.radiojehona.al)



Malik ibn Nebij
(1905 - 1973)

**"DITURIA PA NDËRGJEGJE
është shkatërrim për shpirtin,
POLITIKA PA MORAL
është shkatërrim për popullin!"**

Myftinia Shkodër
www.myftinia-shkoder.org
mail@myftinia-shkoder.org



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org